

**“INTER DISTRIBUTION SERVICES” SH.P.K.**

**PASQYRAT FINANCIARE TË VITIT 2019  
së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur  
(Për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2019)  
( në LEKË )**



**PËRMBAJTJA**

<b>EMËRTIMI</b>	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7-23



## Pasqyra e pozicionit financiar

Aktive		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>		<b>762,894,505</b>	<b>654,395,372</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	67,122,219	157,388,173
Llogari te arketueshme tregtare	5	362,642,139	205,096,550
Inventar	6	311,661,286	287,432,987
Të arkëtueshme të tjera	7	17,717,668	2,802,974
Tatim fitimi i parapaguar	22	3,751,193	1,674,688
<b>Aktivitet afatgjata</b>		<b>5,071,565</b>	<b>467,017</b>
Aktive afatgjata materiale	8	3,992,833	467,017
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,078,732	-
<b>Totali I aktiveve</b>		<b>767,966,070</b>	<b>654,862,389</b>
<b>Detyrimet</b>		<b>463,689,548</b>	<b>334,048,133</b>
Llogari te pagueshme	10	3,731,643	20,946,170
Të pagueshme të tjera	11	17,249,904	12,178,764
Hua nga palet e lidhura	12	442,708,001	300,923,199
<b>Kapitali aksionar</b>		<b>304,276,522</b>	<b>320,814,256</b>
Kapitali aksionar	13	90,000,000	90,000,000
Fitim ose humbja	13	214,276,522	230,814,256
<b>Total detyrime dhe kapital</b>		<b>767,966,070</b>	<b>654,862,389</b>

Këto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-26, të cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

Ekonomist

Administrator

Ana Hlysi Zervoi



## Pasqyra e performancës

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga shitjet	14	13,855,623,912	13,717,744,647
Kosto e mallrave të shitur	15	-13,447,024,601	-13,310,246,337
<b>Fitimi bruto</b>		<b>408,599,311</b>	<b>407,498,310</b>
Shpenzime te personelit	16	-105,556,667	-71,697,948
Shpenzime administrative	17	-77,822,417	-54,308,821
Shpenzime amortizimi	8 & 9	-1,043,380	-263,471
Shpenzime operative	18	-10,761,881	-5,024,521
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>-195,184,345</b>	<b>-131,294,761</b>
<b>Fitimi nga aktiviteti operativ</b>		<b>213,414,966</b>	<b>276,203,549</b>
Kosto financiare	19	-22,908,959	-19,387,500
Të ardhura/(humbje) neto nga kursi i këmbin	20	1,078,988	14,874,570
Të ardhura të tjera	21	60,864,498	433,177
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>252,449,493</b>	<b>272,123,796</b>
Shpenzime për tatim fitimin	22	-38,172,971	-41,309,540
<b>Fitimi neto i vitit</b>		<b>214,276,522</b>	<b>230,814,256</b>

Këto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-26, të cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

**Ekonomist**

**Administrator**



## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi / (humbja) para tatimit	252,449,493	272,123,796
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	1,043,380	-263,471
Shpenzime interes i	22,599,196	19,287,313
Shpenzime jo monetare	-1,175,401	0
<b>punues:</b>	<b>274,916,668</b>	<b>291,147,638</b>
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	-157,545,589	-41,755,629
Rritje në llogaritë e arkëtueshme të tjera	-14,914,694	-800,605
Rritje/(rënie) në inventar	-24,228,299	29,704,483
Rritje në llogaritë e pagueshme	-17,214,527	16,669,513
Ritje në llogari të pagueshme të tjera	5,071,140	-889,977
Interesi i paguar	-24,137,095	-17,749,414
Tatim fitimi i paguar	-40,249,475	-46,461,134
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>1,698,129</b>	<b>229,864,875</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit</b>		
Blerje e aktiveve fikse materiale	-5,647,928	0
Shitje e aktiveve fikse materiale	0	850,308
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto në veprimtaritë e investimit</b>	<b>-5,647,928</b>	<b>850,308</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e financimit</b>		
Hua të marra nga ortakët	959,753,600	458,996,049
Ripagimi i huave për ortakët	-815,255,499	-443,017,331
Terheqje nga zvogelim kapitali	-90,000,000	0
Kontribut në kapital (në para)	90,000,000	0
Dividente të paguar	-230,814,256	-247,616,517
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e gjeneruar nga veprimtaritë e fin</b>	<b>-86,316,155</b>	<b>-231,637,799</b>
<b>Rënie neto në mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre</b>	<b>-90,265,954</b>	<b>-922,616</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	157,388,173	158,310,789
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>67,122,219</b>	<b>157,388,173</b>

Këto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-26, të cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

Ekonomist



Administrator



**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto**

	Kapitali	Fitimi i pashpe rdare	Total
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2017</b>	<b>90,000,000</b>	<b>247,616,516</b>	<b>337,616,516</b>
Fitimi neto i vitit		230,814,256	230,814,256
Shperndarje fitimi	0	-247,616,516	-247,616,516
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2018</b>	<b>90,000,000</b>	<b>230,814,256</b>	<b>320,814,256</b>
Fitimi neto i vitit	0	214,276,522	214,276,522
Shperndarje fitimi	0	-230,814,256	-230,814,256
Zvogelim kapitali nga fitimi	-90,000,000	0	-90,000,000
Zmadhim kapitali me kontribut ne para	90,000,000	0	90,000,000
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2019</b>	<b>90,000,000</b>	<b>214,276,522</b>	<b>304,276,522</b>

Këto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-26, të cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

**Ekonomist**

**Administrator**



**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**

**1. Informacion i përgjithshëm**

Inter Distribution Services Sh.p.k. (referuar si “Shoqëria”) është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar më 05 Prill 2007, dhe operon në përputhje me legjislacionin në fuqi nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat si dhe ligjet e industrisë ku operon shoqëria.

Objekti i veprimtarisë: Gjatë vitit 2019 shoqëria ka kryer veprimtari në fushën e importit, eksportit dhe tregëtisë me shumicë dhe pakicë të produkteve cigareve të llojave të ndryshme, të duhanit me ngohje e pajisjeve e aksesorëve përkatës. Të gjitha këto veprimtari janë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë dhe konform statutit e ligjeve në fuqi.

Kapitali i regjistruar: Vlera e kapitalit me 31 Dhjetor 2019 është 90,000,000 Lekë (31.12.2018: 90,000,000 LEKE) dhe përbëhet nga 3 kuota me vlerë nominale të ndryshme të kontributit në para.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët:

1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Investment Joti – Infosoft Group” sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Z. Grigor Joti, e cila zotëron një kuotë, që përfaqëson 33.33% të kapitalit të Shoqërisë;
2. Z. Plarent Kristo, i cili zotëron një kuotë, që përfaqëson 33.33% të kapitalit të Shoqërisë;
3. Z. Roland Joti, i cili zotëron një kuotë, që përfaqëson 33.33% të kapitalit të Shoqërisë.

Shoqëria drejtohet nga administrator: Znj. Ana (Hysi) Zervoi , nga z. Alban Ujkashej deri me 31.12.2019 dhe z. Ylli Shemeti nga data 01.01.2020, me të drejta, detyra , kufizim të kompetencave dhe afat të ndryshëm emërimi, të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe të publikuar në regjistrin tregtar.

Adresa e selisë : Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, KM.1, Pasuria Nr. 51/19, ZK. 2679, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë nuk janë në pronësi të shoqërisë.

Me datë 31 Dhjetor 2019 shoqëria kishte 74 punonjës (me 31 Dhjetor 2018 ishte 46 punonjës).

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

**2.1. Bazat e përgatitjes**


Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”). Shoqëria mban kontabilitetin dhe raporton pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”), të shpallura me Urdhërin e Ministrisë të Financave Nr. 64 datë 22.07.2014 dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me efekt nga data 1 janar 2019.

**2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

**3.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar (“LEKE”), e cila është monedha funksionale apo e mjedisit ekonomik kryesor, në të cilin vepron Shoqëria. Monedha e paraqitjes është Lek shqiptar (“LEKE”). Të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveçse ku shprehet ndryshe.





#### 2.4 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që Shoqëria ka burime të mjaftueshme dhe perspektivë për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë paisigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

#### 2.5 Kompesimi (netimi)

Aktivitetet dhe detyrimet financiare janë të kompensuar me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm në qoftë se ekziston një e drejte ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe Shoqëria ka një synim për t'i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitetet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim kontabël.

#### 2.6. Gjykime të rëndësishme kontabel, vlerësime dhe supozime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabel të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabel janë:

- vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
- vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit dhe i zhvlerësimeve të aktiveve;
- krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabel të cilat kanë efektet më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.
- Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumën që është regjistruar fillimisht, diferencat do të ndikojnë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabel

Politikat kontabel të përshkruara më poshtë janë zbatuar janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria. Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabel që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me kosto historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuara minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivitetet dhe pasivet e tjera duhet të referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.





### **3.1 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësive ekonomike raportuese, duke përfshiruar këtu ato flukse që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital.

Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### **3.2 Shitja e mallrave**

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;

(b) njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;

(c) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;

(d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike;

(e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

### **3.3 Kontratat e shërbimit**

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).

### **3.4 Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat perkatese. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësive ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njësia ekonomike nuk prët përfitime të ardhshme, njihen menjëherë në rezultatin financiar.

### **3.5 Transaksionet e qirase**

Qiraja është një marrëveshje ku qiradhënësi i kalon qiramarrësit të drejtën e përdorimit të një aktivi për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt një ose disa pagesave. Marrëveshjet e qirasë do të klasifikohen ose si qira financiare ose si qira e zakonshme. Faktori përcaktues për klasifikimin e qirave është niveli deri ku rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e një aktivi të dhënë me qira i takojnë qiramarrësit apo qiradhënësit.

Meqenëse transaksioni mes qiradhënësit dhe qiramarrësit bazohet në një marrëveshje qiraje të përbashkët, që është e detyrueshme për të dyja palët, të dyja palët duhet të përdorin të njëjtat përkufizime kur bëjnë klasifikimin e marrëveshjeve të qirasë. Nga ana tjetër, meqenëse të dyja palët përdorin supozime të ndryshme për klasifikimin e marrëveshjeve të qirasë, në rrethana të caktuara, qiradhënësi dhe qiramarrësi mund të klasifikojnë të njëjtën marrëveshje qiraje në mënyra të ndryshme.





Qiraja financiare është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivit. Titulli mund t'i kalojë ose jo qiramarrësit.

Qiraja e zakonshme është çdo lloj qiraje tjetër, përveç asaj financiare, d.m.th. është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit nuk i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivit.

### **3.6 Instrumentat financiare**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera, te arkëtueshme dhe te pagueshme nga njesite ekonomike pjesë e grupit, huamarrjet dhe huadheniet.

### **3.7 Aktivet financiare**

Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësi duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Në këtë rast janë përfshirë kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, hua si dhe kërkesa të tjera debitore afatshkurtra, të cilat në njohjen fillestare janë vlerësuar me vlerën e paskontuar apo me koston e transaksionit. Pas njohjes fillestare, aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësi duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje

### **3.8 Detyrimet financiare**

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, ortakëve për dividendë, hua dhe interesa, punonjësve, administratës tatimore, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen sipas rastit me kosto apo me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.


Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale paguhen, anulohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

### **3.9 Inventarët**

Inventarët janë aktivet e mbajtura nga shoqëria për shitje në rrjedhën normale të aktivitetit të saj. Ajo njihet inventarin atëherë kur e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet





me besueshmëri. Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin përveç çmimit të blerjes, zbritjet tregtare dhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Pas njohjes fillestare njësisë ekonomike e mat inventarin me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur. Për të përcaktuar koston e inventarit shoqëria përdor metoden koston mesatare të ponderuar.

### **3.10 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, si pjesë e aktiveve financiare, përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara ose me maturitet tre muaj ose më pak, të përcaktuara si më sipër.

### **3.11 Detyrime/të drejta tatimore**

Si pjesë e një aktivi apo detyrimi financiar, të drejtat dhe detyrimet tatimore përfshijnë të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të paguara dhe për tu paguar ndaj administratës tatimore, të cilat vlerësohen me kosto (me vlerë të paskontuar). Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontohen dhe nuk zhvlerësohen.

### **3.12 Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale (AAM dhe AAJM)**

Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që përdoren nga njësisë ekonomike për kryerjen e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve apo përdoren për qëllime administrative, për më shumë se një periudhë kontabël. Aktivet afatgjata materiale maten me kosto dhe paraqiten në pasqyrat financiare me vlerë neto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka klasifikuar si aktive afatgjata materiale inventarët që përdoren për qëllime administrative dhe përbehen pajisje informatike, programe informatike, mobilje e pajisje zyre, etj. Aktivet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet normale për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM e shoqërisë, është metoda e vlerësimit mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuar janë paraqitur në tabelën më poshtë, ku vlen të theksohet që për vitin 2019 shoqëria nuk ka ndryshuar normat e amortizimit.


<b>Pershkrimi</b>	<b>Norma vjetore</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>
Pajisje informatike	25%	Me vlerë e mbetur
Programe informatike	25%	Me vlerë e mbetur
Pajisje pune e orendi	20%	Me vlerë e mbetur

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivet në proces nuk amortizohen.

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.





### **3.13 Provizionet**

Provizioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose kontraktual dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh ( përfitimet ekonomike) për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim

### **3.14 Përfitimet e punonjësve**

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

### **3.15 Kapitali**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kuota e kapitalit, e cila përfaqëson kontributin e ortakëve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Kapitali njihet me kosto, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërisë.

### **3.16 Shpërndarjet e fitimit**

Shoqëria i njeh shpërndarjet e fitimit si detyrim, në kohën e deklarimit të tyre.

### **3.17 Të ardhura të tjera dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e interesit efektiv (kontabilizimi, në bazë të normës së brendshme të interesit efektiv, përshkruhet gjithashtu në SKK 3, Instrumentet Financiare); Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare afatshkurtra si dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). Të ardhurat nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto.

### **3.18 Tatimi mbi të ardhurat**


Tatim fitimi përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkt në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferencë të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

### **3.19 Transaksionet në valute të huaja**

Regjistrimet kontabël të shoqërisë përgatiten në Lek (ALL), që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në



**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin. Kurset e këmbimit të përdorura për vlerësimin e gjendjeve në monedhe tjetër me datë 31.12.2019 dhe 31.12.2018 janë:

Monedha	31.12.2019	31.12.2018
EUR	121.77	123.42
USD	108.64	107.82

**4. Mjete monetare dhe të ngjashme**

Gjendjet e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten të detajuara si më poshtë:

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<b>Paraja në Bankë</b>	<b>67,105,062</b>	<b>157,349,106</b>
Lek	65,401,165	154,976,319
EUR	1,703,897	2,372,787
<b>Paraja në arkë</b>	<b>17,157</b>	<b>39,067</b>
Lek	17,157	39,067
<b>Totali</b>	<b>67,122,219</b>	<b>157,388,173</b>

Vlera e mesiperme përfaqëson vlerën e likuiditeteve me datë 31.12.2019, gjendje në llogarite që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në lekë dhe valute si dhe gjendjen në arke. Gjendja e likuiditeteve (në banke) e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankës.

**5. Te drejta të arketueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Llogari të arketueshme tregtare	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari të arketueshme tregtare	315,819,002	189,997,069
Llogari të arketueshme nga shërbimet e distribucionit	47,154,937	15,099,481
Zhvlerësim i Klienteve	(331,800)	-
<b>Totali</b>	<b>362,642,139</b>	<b>205,096,550</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur të drejtat për tu arkëtuar nga aktiviteti i shitjes së mallrave e shërbimeve dhe zhvlerësimi i llogaritur për një klient me vonesë.





**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

<b>Zhvierësimi i klienteve</b>	<b>31.12.2019</b>	<b>31.12.2018</b>
Balanca me 1 Janar	0	0
Shtesa e vitit	-331,800	0
Rimarrje e vitit	0	0
<b>Balanca me 31 Dhjetor</b>	<b>-331,800</b>	<b>0</b>

**6. Inventarët**

Në periudhën raportuese inventarët paraqiten si vijon:

<b>Inventari</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Inventari i mallrave	311,326,818	286,846,386
Materiale konsumi	334,468	586,601
<b>Totali</b>	<b>311,661,286</b>	<b>287,432,987</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur gjendja e inventareve qarkullues, të cilat përbehen nga cigare të llojave të ndryshme, duhan me ngrohje dhe aksesoret e tyre, të gatshme për shitje. Shoqëria ka vlerësuar gjendjen e inventarit me koston e blerjes.

**7. Të arkëtueshme të tjera**

<b>Të arkëtueshme të tjera</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Të arkëtueshme të tjera	3,705,412	3,217,254
Zhvierësim i debitorëve	(2,884,060)	(2,884,060)
Shpenzime të periudhave të ardhshme	1,465,722	158,964
TVSH e arkëtueshme	3,499,746	2,310,816
Të arkëtueshme të konstatuara	11,930,848	-
<b>Totali</b>	<b>17,717,668</b>	<b>2,802,974</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur të arkëtueshme nga debitorë të tjerë me vlerë 3,705,412 Leke dhe zhvierësimi përkatës. Nuk ka patur përkeqësim të situatës së debitorëve gjatë vitit 2019, pasi vlerat e krijuara gjatë këtij viti janë arketuar në 2020. Po kështu janë paraqitur shpenzimet e periudhave të ardhshme që i përkasin periudhës pas datës 31.12.2019, me vlerë 1,465,722 Lekë, kërkesa për tu arketuar nga shteti për TVSH si dhe të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara, të faturuara në vitin 2020, por që lidhen me shpenzime të njohura në vitin 2019.

<b>Zhvierësimi i debitorëve</b>	<b>31.12.2019</b>	<b>31.12.2018</b>
Balanca me 1 Janar	-2,884,060	0
Shtesa e vitit	0	-2,884,060
Rimarrje e vitit	0	0
<b>Balanca me 31 Dhjetor</b>	<b>-2,884,060</b>	<b>-2,884,060</b>

Nga analiza e debitorëve nuk rezultoi zhvierësim për vitin 2019.





8 & 9. Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale

Kosto	Pajisje kompjuterike dhe zyre	Total AAM	Programe kompjuterike	Total AAJM
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2017</b>	<b>3,997,338</b>	<b>3,997,338</b>	-	-
Shtesa	-	-	-	-
Pakesime	(1,973,599)	(1,973,599)	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2018</b>	<b>2,023,739</b>	<b>2,023,739</b>	-	-
Shtesa	4,546,243	4,546,243	1,101,685	1,101,685
Pakesime	-	-	0	0
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2019</b>	<b>6,569,982</b>	<b>6,569,982</b>	<b>1,101,685</b>	<b>1,101,685</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2017</b>	<b>(2,943,485)</b>	<b>(2,943,485)</b>	-	-
Zhvleresimi I vitit	(263,471)	(263,471)	-	-
Pakesime	1,650,234	1,650,234	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2018</b>	<b>(1,556,722)</b>	<b>(1,556,722)</b>	-	-
Zhvleresimi I vitit	(1,020,427)	(1,020,427)	(22,953)	(22,953)
Pakesime	-	-	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2019</b>	<b>(2,577,149)</b>	<b>(2,577,149)</b>	<b>(22,953)</b>	<b>(22,953)</b>
<b>Vlera e mbetur</b>				
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>3,992,833</b>	<b>3,992,833</b>	<b>1,078,732</b>	<b>1,078,732</b>
<b>Me 31 dhjetor 2018</b>	<b>467,017</b>	<b>467,017</b>	-	-
<b>Me 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,053,853</b>	<b>1,053,853</b>	-	-

Aktivitet afatgjata materiale përbëhen nga aktive që përdoren për qëllime administrative dhe të operacioneve tregtare, pajisje dhe programe informatike, nga pajisje pune, mobilje e orendi, të cilat janë prone e shoqërisë, janë dokumentuar në mënyrë të rregullt dhe priten përfitime ekonomike në të ardhmen.

10. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Shoqëria ka detyrime të pagueshme me 31.12.2019 dhe 31.12.2018, në vlerat si në vijim, të cilat janë paguar në vitin 2020.

Llogari të pagueshme tregtare	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari të pagueshme tregtare ndaj furnitorëve	3,731,643	20,946,170
<b>Totali</b>	<b>3,731,643</b>	<b>20,946,170</b>

11. Të pagueshme të tjera

Në mënyrë të detajuar detyrimet e tjera të pagueshme me 31.12.2019 janë si vijon:



**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

<b>Të pagueshme të tjera</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Të pagueshme ndaj personelit	8,406,894	5,308,976
Sigurime shoqerore e shendetesore	2,249,713	1,389,989
Tatime të pagueshme (TAP & tatim burim)	2,209,967	1,607,773
Shpenzime të përlllogaritura	541,330	32,026
Parashikime per detyrime tatimore	3,840,000	3,840,000
Kreditore te tjere	2,000	-
<b>Total</b>	<b>17,249,904</b>	<b>12,178,764</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur të gjitha llojet e detyrimeve të tjera ndaj punonjësve, administratës tatimore, si dhe shpenzime te perlllogaritura te cilat do te mbyllet ne 2020. Per llogaritjen e detyrimeve dhe të drejtave tatimore, shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për tatimet e taksat. Vlerat e raportuara në këto pasqyra financiare janë një vetë-vlerësim i kryer nga shoqëria, ndaj nuk konsiderohen si shuma përfundimtare. Administrata tatimore është i vetmi autoritet për të vlerësuar saktësinë e vlerësimeve të kryera nga shoqëria.

**12. Hua nga ortakët**

<b>Hua nga ortakët</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Hua nga Z. Grigor Joti	200,000,000	12,864,877
Hua nga Investment Joti Sh.p.k	-	87,278,800
Hua nga Z. Roland Joti	97,000,000	99,620,801
Hua nga Z. Plarent Kristo	145,708,001	99,620,822
Interes i përlllogaritur për huanë	-	1,537,899
<b>Total</b>	<b>442,708,001</b>	<b>300,923,199</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur detyrimet për hua të marra nga ortakët, për kapital pune, referuar kontratave respective:

-Kontrata e huase me Z. Grigor Joti, me afat nga 20.12.2015 deri me 04.11.2020, për shumën limit prej 300 milion Leke.;

-Kontrata e huase me Z. Plarent Kristo, me afat nga 31.12.2015 deri me 31.12.2021 për shumen maksimale limit deri 300,000,000 leke;

-Kontrata e huase me Z. Roland Joti, me afat nga 31.12.2015 deri me 31.12.2021 për shumen maksimale limit deri 300,000,000 leke.

Interesat e huave janë llogaritur respektivisht sipas kontrates, në bazë të normës mesatare 12 mujore te interesit të kredisë të shpallur nga Banka e Shqiperise per vitin 2019. Interesat janë të pagueshme në muajin pasardhës pas mbarimit të çdo 3-mujori. Interesat e maturuara të vitit 2019 janë paguar në Dhjetor 2019.

**13. Kapitali i paguar**

Gjendja e kapitalit me date 31.12.2019 dhe me 31.12.2018 ishte si vijon:

<b>Ortakë:</b>	<b>Ne %</b>	<b>31.12.2019</b>	<b>Ne %</b>	<b>31.12.2018</b>
Investment Joti-Infosoft Group Sh.p.k.	33.33%	30,000,000	33.33%	30,000,000
Z. Roland Joti	33.33%	30,000,000	33.33%	30,000,000
Z. Plarent Kristo	33.33%	30,000,000	33.33%	30,000,000
<b>TOTAL</b>	<b>100%</b>	<b>90,000,000</b>	<b>100%</b>	<b>90,000,000</b>



**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

Gjendja e kapitalit me date 31.12.2019 nuk ka ndryshuar as në strukturë dhe as në vlerë në krahasim me gjendjen me 31.12.2018, por gjatë vitit 2019 janë kryer procedurat e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit, me vlerë 90,000,000 Lekë, të cilat kanë ndryshuar burimin e kapitalit.

Me Vendim VOA nr. 93, dt. 11.04.2019, Ortakët kanë zmadhuar kapitalin me kontribute në para, me vlerë 90,000,000, proporcionalisht me përqindjen e secilit ortak në kapital.

Me Vendim VOA nr. 96, dt. 12.04.2019, Ortakët kanë zvogëluar kapitalin e shoqërisë nga 180,000,000 lekë në 90,000,000 lekë, pra për vlerën 90,000,000 lekë. Kjo vlerë ka rezultuar nga fitimi i pashpërndarë i cili ishte kapitalizuar në periudhat e mëparshme. Ortakët Individë kanë paguar tatimin 8% mbi vlerën e kapitalit të përfituar nga zvogëlimi.

Me vendim APO nr. 92, dt. 11.04.2019, Ortakët kanë vendour për shpërndarjen e fitimit të vitit 2018 me vlerë 230,814,256 Lekë, në raportet e përcaktuara në statut.

Të gjitha procedurat e regjistrimit dhe deklarimit janë kryer rregullisht.

#### **14. Të ardhura nga shitjet**

Në këtë rubrikë janë paraqitur të ardhurat neto nga veprimtaria operacionale e shoqërisë.

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave, neto	13,855,623,912	13,717,744,647
	-	-
<b>Totali</b>	<b><u>13,855,623,912</u></b>	<b><u>13,717,744,647</u></b>

Zbritjet nga shitjet dhe komisionet përfaqësojnë zbritjet të kryera gjatë vitit në bazë të kontratave me klientët, me qëllim rritjen e shitjeve dhe të objektivave të përcaktuara.


#### **15. Kosto e mallrave të shitura**

Në këtë rubrikë janë paraqitur kostot e kryera në funksion të realizimit të shitjeve.

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Kosto e mallrave të shitura	(13,447,024,601)	(13,310,246,337)
	-	-
<b>Totali</b>	<b><u>(13,447,024,601)</u></b>	<b><u>(13,310,246,337)</u></b>

#### **16. Shpenzime të personelit**

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Shpenzimet e pages	(93,112,204)	(63,671,541)
Shpenzimet e sig.shoqërore dhe shendet.	(12,444,463)	(8,026,407)
<b>Totali</b>	<b><u>(105,556,667)</u></b>	<b><u>(71,697,948)</u></b>





**17. Shpenzime administrative**

Në tabelën në vijim janë paraqitur shpenzimet e kryera nga shoqëria në funksion të aktivitetit tregtar, të klasifikuara sipas natyrës.

	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Shpenzime karburanti	(8,562,977)	(6,628,107)
Shpenzime qiraje	(20,969,723)	(16,975,384)
Shpenzime mirëmbajtje	(660,498)	(617,702)
Shpenzime sigurmi	(264,534)	(33,500)
Shpenzime për shërbime	(37,298,172)	(25,097,342)
Shpenzime marketingu të Shoqërisë	-	(131,458)
Shpenzime transporti	(8,931,859)	(3,783,022)
Shpenzime marketing te kompensuara nga Philip	-	-
Shpenzime të tjera	(1,134,653)	(1,042,306)
<b>Totali</b>	<b>(77,822,416)</b>	<b>(54,308,821)</b>

Vlera e kësaj rubrike në vitin 2018 ishte -92,047,279 Lekë, ndërsa është -54,308,821 Lekë. Diferenca prej -37,734,779 Lekë, e cila përfaqëson zbritje akorduar klientëve, por të rimbursuara nga PHI, është riklasifikuar në shënimin nr.21 më poshtë, për të qenë i krahasueshëm me vitin 2019 dhe me të ardhurat e kompensuara nga pala e tretë.

**18. Shpenzime të tjera neto**

	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Shpenzime pritje përcjellje	(156,900)	(8,259)
Shpenzime për dieta e udhëtime	(1,443,101)	(1,289,100)
Shpenzime telekomunikacioni neto	(761,502)	(170,773)
Shpenzime të tjera	(1,938,578)	(679,529)
Shpenzime donacioni per termetin	(6,130,000)	-
Shpenzime për zhvlerësim	(331,800)	(2,876,860)
<b>Totali</b>	<b>(10,761,881)</b>	<b>(5,024,521)</b>

Në këtë rubrikë vlen të veçojme shpenzimet e kryera nga shoqëria për donacione me vlere 6,130,000 Lekë.

**19. Shpenzime Financiare Neto**

	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Komisione bankare	(842,766)	(2,093,153)
Shpenzime interesi	(22,599,196)	(17,562,586)
Te ardhura nga interesi	533,003	268,239
<b>Totali</b>	<b>(22,908,959)</b>	<b>(19,387,500)</b>

**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

Në këtë rubrikë janë paraqitur shpenzimet financiare si komisione për shërbime bankare dhe garanci bankare, si dhe shpenzime interesi për huatë nga palët e lidhura.

**20. Fitimi neto nga kursi i këmbimit**

	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Humbje neto nga kursi i këmbimit	(1,394,441)	(63,766,076)
Fitimi neto nga kursi i këmbimit	2,473,429	78,640,646
<b>Totali</b>	<b>1,078,988</b>	<b>14,874,570</b>

**21. Të ardhura të tjera**

	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Të ardhura të tjera	519,048	433,179
Te ardhura te tjera nga Philip Morris Inter.	60,345,450	-
Kompensime per zbritje dhene klienteve	48,759,430	37,734,776
Zbritje dhene klienteve	(48,759,430)	(37,734,778)
<b>Totali</b>	<b>60,864,498</b>	<b>433,177</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shoqërisë si dhe kompensimet e marra për zbritjet e akorduara klienteve (shihni komentin në shënimin nr.17, për riklasifikimin e shpenzimit prej 37,734,776 Leke, në këtë rubrikë, i cili sjell si pasojë uljen e vlerës së të ardhurave të raportuara në vitin 2018 me të njejtën vlerë, nga 38,167,955 Lekë në 433,177 Lekë).

**22. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin**

	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>252,449,493</b>	<b>272,123,796</b>
Të ardhura të patatueshme	-	-
Shpenzime te pazbritshme	2,036,982	3,273,139
<b>Fitimi tatimor i ushtrimit</b>	<b>254,486,475</b>	<b>275,396,935</b>
Humbje te mbartura	-	-
<b>Fitimi i tatueshem i ushtrimit</b>	<b>254,486,475</b>	<b>275,396,935</b>
Norma e tatim fitimit 15%	15%	15%
<b>Tatim fitimi aktual</b>	<b>-38,172,971</b>	<b>-41,309,540</b>

Sikurse shihet nga tabela e mesiperme, janë evidentuar shpenzimet e panjohura në total per 2,036,982 Leke (31.12.2018: 3,273,139 Leke). Nuk ka humbje të mbartura për vitin 2019. Bazuar në këto rregullime Fitimi i tatueshem i vitit rezulton 254,486,475 Leke (31.12.2018: 275,396,935 Leke) dhe shpenzimi per tatim fitimi per vitin 2019 është 38,172,971 Lekë (31.12.2018: 41,309,540 leke).

Lëvizja në llogarinë e Tatim fitimit të vitit 2019 është si vijon:



**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

Lëvizja e tatim fitimit aktual	Viti 2019	Viti 2018
Balanca me 1 Janar	1,674,688	-3,476,906
Paguar gjatë vitit	40,249,475	46,461,134
Shpenzimi i vitit	-38,172,971	-41,309,540
Balanca me 31 Dhjetor	<b>3,751,193</b>	<b>1,674,688</b>

**23. Palët e lidhura**

Në rrjedhën e kryerjes së veprimtarisë operacionale, Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme me palët e lidhura. Për periudhën e mbyllur 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, kanë ndodhur transaksionet me palët e lidhura si më poshtë:

Detyrime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
<b>Të pagueshme tregtare për palët e lidhura</b>		
Furnitore IMLS Shpk	1,999,040	2,337,840
Hua nga ortakët	442,708,001	300,923,199
<b>Totali</b>	<b>444,707,041</b>	<b>303,261,039</b>
<b>Efekte ne rezultatin financiar</b>	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Të ardhura nga palët e lidhura	0	8760
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>8,760</b>
<b>Blerje shërbimesh nga palët e lidhura</b>		
IMLS Shpk	70,543,225	56,038,790
<b>Totali</b>	<b>70,543,225</b>	<b>56,038,790</b>
<b>Interes</b>		
Interesi i maturuar nga huatë e ortakëve	22,599,196	17,562,586
<b>Totali</b>	<b>22,599,196</b>	<b>17,562,586</b>
<b>Kompensimi i Administratoreve</b>	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2018</b>
Page dhe shperblime bruto	6,306,559	4,734,361
<b>Total</b>	<b>6,306,559</b>	<b>4,734,361</b>

**24. Menaxhimi i rrezikut financiar**

**Faktorët e rrezikut financiar**

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

**Rreziku i tregut**

**Rreziku i kursit të këmbimit**






**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me EUR dhe USD. Shoqëria gjate vitit 2019 ne ndryshim nga viti 2018, ka minitoruar rrezikun e kursit të këmbimit.

Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria mban aktivet dhe detyrimet të shprehura në euro. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më pak ose më shumë se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të kursit të këmbimit të Shoqërisë është i kufizuar pasi transaksionet në monedhat lekë dhe euro janë të kufizuara.

Ekspozimi i Shoqërisë me kursin e këmbimit në 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>Total</b>	<b>Euro</b>	<b>Lek</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	67,122,219	1,703,897	65,418,322
Të drejta të arketueshme	362,642,139		362,642,139
Të arkëtueshme nga palët e lidhura			
Të tjera të arkëtueshme	21,468,861		20,655,062
<b>Total aktive financiare</b>	<b>451,233,219</b>	<b>1,703,897</b>	<b>448,715,523</b>
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(3,731,643)		(3,731,643)
Hua nga palët e lidhura	(442,708,001)	(48,708,001)	(394,000,000)
Të pagueshme të tjera	(17,249,904)		(17,249,904)
<b>Total detyrime financiare</b>	<b>(463,689,548)</b>	<b>(48,708,001)</b>	<b>(414,981,547)</b>
<b>Pozicioni valutor neto</b>	<b>(12,456,329)</b>	<b>(47,004,104)</b>	<b>33,733,976</b>

Ekspozimi i Shoqërisë me kursin e këmbimit në 31 dhjetor 2018 ishte si më poshtë:

<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>Total</b>	<b>Euro</b>	<b>Lek</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	157,388,173	2,372,787	155,015,386
Të drejta të arketueshme	205,096,550	-	205,096,550
Të tjera të arkëtueshme	2,802,974	-	2,802,974
<b>Total aktive financiare</b>	<b>365,287,697</b>	<b>2,372,787</b>	<b>362,914,910</b>
Hua nga palët e lidhura	(300,923,199)	(76,520,423)	(224,402,776)
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(20,946,170)	-	(20,946,169)
Të pagueshme të tjera	(12,178,764)	-	(12,178,759)
<b>Total detyrime financiare</b>	<b>(334,048,133)</b>	<b>(76,520,423)</b>	<b>(257,527,704)</b>
<b>Pozicioni valutor neto</b>	<b>31,239,564</b>	<b>(74,147,636)</b>	<b>105,387,206</b>

Vlerësimi ose zhvlerësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës EUR më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 do të sillte rritje ose ulje në kapitalin e shoqërisë dhe në rezultatin financiar, në vlerat e poshtëshënuara:

**Inter Distribution Services Sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**

**Ndryshimi ne Fitim/Humbjen e periudhes 31 Dhjetor 2019 31 Dhjetor 2018**

EUR Zhvleresohet/mbivleresohet me 10%	+/- 4,700,410	+/- 7,414,764
<b>Total</b>	<b>+/- 4,700,410</b>	<b>+/- 7,414,764</b>

(ii) *Rreziku nga Taksimi*

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshime që ndodhin shpesh. Si rezultat, transaksionet mund të rivleresohen nga organet tatimore dhe Shoqëria mund të duhet te paguaj taksa shtesë, gjambat dhe interesa, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudhat mbeten të hapura për të shqyrtuar nga organet tatimore dhe doganore në lidhje me detyrimet tatimore për pesë vjet. Manaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të asnjë rrethanë, të cilat mund të sjellin një detyrim të mundshëm material në këtë drejtim.

(iii) *Rreziku i likuiditetit*

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, struktura e maturimit të detyrimeve financiare të Shoqërisë bazuar në pagesat e paskontuara është paraqitur si më poshtë:

<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>&lt;3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vjet</b>	<b>Total</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	67,122,219			67,122,219
Të drejta të arkëtueshme	362,642,139			362,642,139
Të tjera të arkëtueshme		21,468,861		21,468,861
<b>Total</b>	<b>429,764,358</b>	<b>21,468,861</b>	<b>0</b>	<b>451,233,219</b>
Hua ndaj palëve të lidhura		(442,708,001)		(442,708,001)
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(3,731,643)			(3,731,643)
Të pagueshme të tjera	(17,249,904)			(17,249,904)
<b>Total</b>	<b>(20,981,547)</b>	<b>(442,708,001)</b>	<b>-</b>	<b>(463,689,548)</b>
<b>Hendeku i likuidite tit</b>	<b>408,782,811</b>	<b>(421,239,140)</b>	<b>-</b>	<b>(12,456,329)</b>

Ndërsa për vitin 2018:

<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>&lt;3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vjet</b>	<b>Total</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	157,388,173			157,388,173
Të drejta të arkëtueshme	205,096,550			205,096,550
Të tjera të arkëtueshme	2,802,974	-		2,802,974
<b>Total</b>	<b>365,287,697</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>365,287,697</b>
Hua ndaj palëve të lidhura		(300,923,199)		(300,923,199)
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(20,946,170)			(20,946,170)
Të pagueshme të tjera	(12,178,764)			(12,178,764)
<b>Total</b>	<b>(33,124,934)</b>	<b>(300,923,199)</b>	<b>-</b>	<b>(334,048,133)</b>
<b>Hendeku i likuidite tit</b>	<b>332,162,763</b>	<b>(300,923,199)</b>	<b>-</b>	<b>31,239,564</b>

Si kurse shikohet nga keto raporte, situata e likuiditetit e shoqërisë është mjaft e mirë.

**25. Angazhime dhe garanci**

Shoqëria është e përfshirë në kontrata garancie (deri me date 31.12.2020) dhe linja kredie me bankat. Po kështu është palë e paditur ose paditëse në çështe gjyqësore, të cilat janë në proces. Manaxhimi vlerëson që këto çështje nuk do të influencojnë në pozicionin financiar të shoqërisë.

## **26.Ngjarje pas datës së raportimit**

Deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare me datë 23.01.2020 nuk ka patur ngjarje të cilat të ndikonin në gjendjet e deklaruar nga shoqëria me datë 31.12.2019 dhe në shënimet shpjeguese të përfshira në këto pasqyra. Pasqyrat financiare janë autorizuar nga administratori i shoqërisë me datë 01.02.2020.

**Financier**



**Administrator**

*Ara Hys) Zeri*  
*Ara Hys)*

